



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 493/3 Prot.

Tiranë, më 31.05.2024

V E N D I M

Nr. 171, Datë 31.05.2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 58, datë 25.03.2024, në emër të fëmijës S.J, përfaqësuar nga F.J¹ kundër Bashkisë Korçë në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*gjendjes ekonomike*”².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, F.J, në mes të tjerash informon se: “*Në muajin shtator 2023 jam lajmëruar nga mësueset e shkollës “Asdreni” për të dorëzuar dokumentet për përfitimin e bursës për vajzën time, që është nxënëse në klasën e 2-të, e cila ka qenë përfituese e kësaj burse edhe vitin e kaluar. Në muajin janar 2024 dalin listat në shkollë dhe emri i vajzës nuk ishte. Interesohem pranë drejtorisë së shkollës dhe më thuhet se nuk e kemi ne në dorë por Bashkia dhe ju që trajtoheni me ndihmë ekonomike, nuk mund të jeni përfitues i VKM nr. 511, datë 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar”.*

Subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e bursës për vitin shkollor 2023-2024, për vajzën e tij.

¹ Referuar certifikatës familjare datë 23.01.2024, vërtetohet se F dhe E.J janë prindërit e S.J.

² Referuar Vërtetimit datë 23.12.2023 të lëshuar nga Drejtoria e Kujdesit Social e Bashkisë Korçë, vërtetohet se F.J trajtohet me ndihmë ekonomike, me shumën 6.300 lekë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 493/1, datë 28.03.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Bashkia Korçë, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Informacion mbi arsyet se përse fëmija i subjektit ankues nuk e përfiton pagesën e bursës, sikurse pretendon.
 - Kopje të dosjes të dokumentacionit të dorëzuar nga ankuesi.
 - Informacion nëse vajza e ankuesit ka përfituar vitet e kaluara pagesë burse. Nëse po, kopje të aktit/dokumentit provues.
 - Informacion të kategorive sociale, që kanë përfituar bursë gjatë vitit shkollor 2023-2024, nga ana e Bashkisë Korçë, si dhe kopje të dokumentacionit, akteve provuese.

Me shkresën nr. 221, datë 17.04.2024, Bashkia Korçë ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën, duke parashtruar në mes të tjerash se:

“Në lidhje me informacionin e kategorive sociale për përfitim burse për vitin shkollor 2023-2024, vendimet janë bazuar në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 dhe vendimin nr. 511, datë 27.07.2022, të ndryshuar të Këshillit të Ministrave dhe shkresave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Me shkresën nr. 527, datë 23.08.2023, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka planifikuar dhe miratuar 3600 (tre mijë e gjashtëqind) bursa në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku për 61 Bashki në rang Republike i takojnë çdo Bashkie 59 bursa.

Sipas shkresës nr. 6470, datë 16.10.2023 për planifikimin e numrit të bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2023-2024, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, përcaktohet se përfitojnë bursë:

- *Sipas kriterit ekonomik: a) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe që akomodohen në konvikte publike; b) nxënësit e arsimit parauniversitar të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, të cilët plotësojnë kriterin ekonomik sipas pasqyrës nr.1, që akomodohen në konvikte publike; c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë;*

- *Kriterit joekonomik: a) nxënësit të cilët kanë përfitur statusin e jetimit, b) nxënësit të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë, c) nxënës të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik si dhe nxënësit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga komisioni mjeko-ligjor, ç) nxënësit të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo dëgjojnë, d) nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit, e) nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktimat e trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror, ë) nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën për shkak të detyrës, g) nxënësit me një prind, kur njëri prej prindërve nuk jeton.*

Në shkresën e sipërcituar kërkohet:

- *Bashkëpunim dhe bashkërendim i punës ndërinstitutionale, për shpalljen apo bërjen publike të kërkesave, kriterëve, procedurave dhe afateve për aplikim për bursa nga prindërit, familjarët, kujdestarët ligjorë, institucionet e arsimit special, si dhe institucionet arsimore, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar.*
- *Kërkesa për numrin e bursave që planifikohet/parashikohet të përfitojnë nxënësit të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2023-2024 duhet të dërgohet zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, jo më vonë se data 31.10.2023.*
- *Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategoritë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, po që në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, me qëllim uljen e nivelit të braktisjes shkollore, mund të miratojnë fonde buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.*

Me shkresën nr. 6470/4, datë 20.11.2023, është dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit numri i bursave të miratuara për vitin shkollor 2023-2024: 350 (treqind e pesëdhjetë) bursa, në zbatim të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave.

Është hartuar procesverbali përfundimtar i dokumentacionit të dorëzuar dhe numrit të nxënësve për përfitim burse, me nr.732, datë 29.12.2023 dhe me vendimin e Këshillit Bashkiak Korçë nr. 164, datë 29.12.2023 janë miratuar 129 (njëqind e njëzetë e nëntë) bursa nga fondet e veta të bashkisë (sipas kriterëve të përcaktuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 10.10.2019 dhe nr.511, datë 27.07.2022, të ndryshuar).

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak Korçë nr. 25, datë 29.02.2024 janë miratuar dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) bursa nga fondet e veta (sipas kriterëve të përcaktuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 10.10.2019 dhe nr. 511, datë 27.07.2022, të ndryshuar) ku për arsye objektive të prindërve dhe kujdestarëve ligjorë të nxënësve nuk paraqitën në kohë dokumentacionin e duhur.

Në total janë 498 nxënës përfitues burse sipas kriterëve të përcaktuara më lart, ku 350 bursa mbështeten nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe 148 bursa mbështeten nga Bashkia Korçë pas një vlerësimi të të ardhurave të Bashkisë, nga të cilat 123 bursa i përkasin kriterit ekonomik dhe 375 bursa i përkasin kriterit joekonomik. Për shkak të numrit të madh të aplikantëve për bursa, të numrit të përcaktuar të bursave nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (350) dhe duke u mbështetur në të ardhurat e Bashkisë Korçë, janë respektuar në mënyrë imediate kriteret joekonomike dhe kriteri ekonomik a), b), c) në pamundësi financiare, pa ndihmë ekonomike dhe punëkërkues të papunë, sepse nuk është e specifikuar në ligj, siç është arsyetuar në pikat a) dhe b) të kriterit ekonomik”.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

Ankuesi pretendon se Bashkia Korçë e ka trajtuar vajzën e tij të mitur S.J në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, në shkelje të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, duke mos e trajtuar rastin e fëmijës së tij, si pjesë e kategorisë përfituese të bursës për vitin shkollor 2023-2024, pavarësisht se sipas ankuesit plotëson kriterin ekonomik të përcaktuar në VKM.

Në këtë kuptim, Komisioneri do vijojë trajtimin e ankesës duke analizuar veprimet dhe vendimarrjen e Bashkisë Korçë në zbatim të VKM-së sipërcituar, si dhe duke analizuar faktin nëse fëmija i ankuesit plotëson kushtet për përfitimin e pagesës për nxënësit e arsimit parauniversitar bazë në institucionet arsimore publike.

- Kuadri ligjor i zbatueshëm.

Kushtetuta është akti më i lartë juridik, ligji më i lartë (lex superior), në pajtueshmëri me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera juridike. Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.
2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 16

1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejné njëloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.
2. Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve.

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojné thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojné kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi.

Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojné nga kjo e drejtë.”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim pavarësisht nga gjendja ekonomike e personit. E drejta për arsim garantohet edhe në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe të detyrueshme për t’u zbatuar.

Kështu, në nenin 57, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

“ 1.Kushdo ka të drejtën për arsimim.

.....

5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.”

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor³.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, duke mos parashikuar një të drejtë të veçantë në lidhje me aksesueshmërinë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”*

³³ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: “a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁴. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁵. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme⁶. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14⁷.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur subjekti është diskriminuar:

- a) *në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;*
- b) *në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;*
- c) *nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;*
- d) *nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

⁴ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁵ Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

⁶ Shih: *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

⁷ Shih: *Çështjen Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; *Çështjen Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; *Çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

Konventa për të Drejtat e Fëmijës⁸ është një nga aktet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare në të cilën janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet në të gjitha fushat e jetës së fëmijës.

Disa nga të drejtat kryesore të fëmijëve, sipas Konventës, janë:

E drejta për barazi dhe mosdiskriminim: të gjithë fëmijët kanë të drejta të barabarta. Asnjë prej tyre nuk mund të diskriminohet për shkak gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, gjendjes ekonomike, arsimore dhe sociale, si dhe për çdo shkak tjetër.

Interesi më i lartë i fëmijës: Të gjitha shtetet që kanë nënshkruar Konventën e të Drejtave të Fëmijës duhet t'u sigurojnë mbrojtjen dhe kujdesin për mirëqenien e nevojshme të gjithë fëmijëve.

Ato angazhohen ta realizojnë këtë duke patur parasysh të drejtat dhe detyrat e prindërve të tyre, kujdestarëve të tyre ligjorë dhe personave të tjerë ligjërisht përgjegjës duke marrë masat e nevojshme legjislative dhe administrative.

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u arsimuar. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, sanksionon të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta.

Në nenin 28, të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës⁹, parashikohet se:

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:

a) Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;

e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

Neni 29

1. Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:

(a) Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;

(b) Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Referuar nenit 4, të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, shtetet palë angazhohen të marrin të gjitha masat legjislative, administrative e të tjera të nevojshme, për të vënë në jetë të drejtat e njohura në këtë Konventë.

⁸ Kjo konventë u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989

⁹ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991.

Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës.

Ky ligj, aktet e tjera normative që rregullojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si dhe çdo akt tjetër individual, që nxirret mbi bazë të tyre, i nënshtrohen parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Ligji përcakton se: “...2. Autoritetet publike e jopublike, si dhe gjykatat, kanë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me fëmijët.

3. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.”

Ligji 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënësi duhet t’i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Kështu, në ligjin 69/2012, të ndryshuar, parashikohet se:

Neni 5. E drejta për arsimim.

1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.
2. Në shkollat publike arsimit të detyrueshëm dhe arsimit të mesëm i lartë janë falas.

Neni 6. Parime të përgjithshme.

4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve.
5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.
6. Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.

Neni 19. Përkujdesje për kategori të veçanta të nxënësve.

Kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Format dhe kriteret e përkujdesjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 28. Njësia bazë e qeverisjes vendore.

1. *Njësia e vetëqeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, mbështet: a) nxënësit e familjeve në nevojë; b) nxënësit me arritje të shkëlqyera; c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës; ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore; d) nxënësit me aftësi të kufizuara.*

Në zbatim dhe të legjislacionit të sipërcituar, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

Në pikën 2, 3, 4 dhe 5, të këtij vendimi përcaktohet se:

2. *Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon:*

2.1 Kriteri ekonomik:

.....

- c) *nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.*

3. *Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj kur:*

a) janë ndarë nga trangu familjar;

b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;

c) deklarohen mbetës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluëse;

4. *Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.*

5. *Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollore të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.*

Qëllimi i përbashkët i akteve ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura është që nëpërmjet tyre të garantohet e drejta e fëmijës për arsim.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me vendimin Nr. 148, datë 22.07.2022, ka konstatuar diskriminimin e fëmijëve të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Këshillit të Ministrave. Në këtë kuadër, Komisioneri i është drejtuar Këshillit të Ministrave të marrë masa, për rishikimin e VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, duke shtuar trajtimin me bursë pa kushte shtesë, të nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike.

Lidhur me këtë, në zbatim të vendimmarrjes së Komisionerit, Këshilli i Ministrave miratoi VKM-në nr. 511, datë 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike””, të ndryshuar, duke bërë përfitues në ndryshimet si më poshtë:

- Pika 2.1 “Kriteri ekonomik”, shkronja c) ndryshoi si vijon: “...nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë”....

Sa i përket ndryshimeve të bëra në VKM-në nr. 666/2019, Këshilli i Ministrave me shkresën nr. 4305/2 prot., datë 02.09.2022, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...Shkronja “c”, e nënpikës 2.1, të pikës 2, ka ndryshuar si vijon:... përfitojnë bursë...c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.

Ky ndryshim u bë në zbatim të kërkesës nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vijim të kërkesës së subjektit “Qendra T’Reja”, që e vlerëson si pengesë dhe diskriminuese përdorimin e togfjalëshit “braktisje shkollore” duke e lidhur përfitimin e bursës me të qenit braktisës. Parashikimi i kësaj pike është bërë me qëllim rritjen e aksesit në arsim, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës nga nxënësit e disavantazuar. Bursa për fëmijët e familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë por janë në pamundësi financiare, është parashikuar të jepet pikërisht për të mundësuar ndjekjen e arsimit... ”.

Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas përcaktimeve të nenit 3, të tij, zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale, me përjashtim të kufizimeve të vendosura në nenin 11 të këtij ligji.

Në nenin 4, të këtij Ligji, ndër të tjera përcaktohet se:

“Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

.....

c) *“Bashki/njësi administrative”, është institucioni nën juridiksionin e të cilit personat përfitues, sipas këtij ligji, ushtrojnë të drejtën për të kërkuar mbështetje me të ardhura monetare ose/dhe në natyrë, të cilat u mungojnë plotësisht ose pjesërisht, si dhe për të kërkuar mbështetje për adresimin e situatës së tyre social-ekonomike drejt programeve të tjera sociale, shëndetësore, të punësimit, strehimit;*

d) *“Familje”, është një grup individësh, që lidhen në marrëdhënie bashkëshortore, marrëdhënie prindër-fëmijë, marrëdhënie ndërmjet anëtarëve të familjes dhe ato të kujdestarisë, të cilët jetojnë në të njëjtën strehë;*

e) *“Fëmijë”, është çdo person nën moshën 18 vjeç dhe, në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se personi është fëmijë, ai konsiderohet fëmijë, në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;*

.....

k) *“Ndihma ekonomike”, është mbështetja me para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;*

Në kreun II, *“Përfituesit e asistencës sociale”, neni 6, i po këtij Ligji, përcakton se: “Asistenca sociale përfshin, por nuk kufizohet në, ndihmën ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar, ndihmën e menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe përfitime të tjera, që garantojnë nga ky ligj.”*

Sipas nenit 7, *“Përfituesit e ndihmës ekonomike”, shkronja a, e tij, përfituesit e ndihmës ekonomike janë: “.....a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme”.*

Në analizë të legjislacionit, dokumentacionit dhe informacionit të depozituar nga palët, Komisioneri vëren se:

- Referuar certifikatës familjare, lëshuar në datën 23.01.2024, nga Zyra e Gjendjes Civile Njësia Administrative Korçë, familja e F.J, përbëhet nga katër anëtarë, F.J, bashkëshortja e tij znj. E.J, vajza S.J e datëlindjes 24.01.2016 dhe djali F.J i datëlindjes 02.11.2005.
- Referuar Vërtetimit të datës 23.01.2024, *“Regjistrim si punëkërkues të papunë”*, të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, (DR AKPA) Korçë, vërtetohet fakti se, F.J, është e regjistruar si punëkërkues i papunë pranë Zyrës Vendore të Punësimit ZV AKPA Korçë.
- Referuar Vërtetimit të datës 23.01.2024, *“Regjistrim si punëkërkues të papunë”*, të Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, (DR AKPA) Korçë, vërtetohet

fakti se, znj. E.J, është e regjistruar si punëkërkuese e papunë pranë Zyrës Vendore të Punësimit ZV AKPA Korçë.

- Ndërsa referuar “Vërtetimit” të Drejtorisë së Kujdesit Socila/Bashkia Korçë, lëshuar në datën 23.12.2023, për familjen e F.J, vërtetohet fakti se është një familje e cila trajtohet me ndihmë ekonomike në shumën 6.300 lekë.
- Sipas Vërtetimit nr. 757, datë 23.01.2024, të lëshuar nga Shkolla 9-vjeçare “Asdreni”, Korçë, rezulton se S.J, është nxënëse në klasën e II (dytë), në vitin shkollor 2023-2024, pranë këtij institucioni të arsimit parauniversitar.
- Bazuar në deklarinimin e palës ankuese, i cili nuk është kundërshtuar nga ana e Bashkisë Korçë, cilësohet fakti se, fëmija S.J, ka përfituar bursë për vitin shkollor 2022-2023, bazuar në VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar.
- Për vitin shkollor 2023-2024, (pavarësisht se nga ankuesi pohohet se është dorëzuar dokumentacioni me të njëjtën përmbajtje me atë të vitit paraardhës, fakt i cili nuk është mohuar, kundërshtuar apo provuar e kundërta nga ana e Bashkisë Korçë) fëmija S.J, nxënëse e klasës së II (dytë), në Shkollën 9-vjeçare “Asdreni”, Korçë, nuk ka përfituar bursë me arsyetimin se familja e tij trajtohet me ndihmë ekonomike dhe nuk përmbush kriterin 2.1/c, të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar.
- Nëpërmjet shkresës nr. 493/1, datë 28.03.2024, Komisioneri ka kërkuar parashtrime dhe dokumentacion nga Bashkia Korçë, lidhur me dosjen e aplikimit për bursë, në emër të fëmijës S.J, për vitin shkollor 2022-2023 dhe 2023-2024. Bashkia Korçë nuk solli parashtrime apo dokumentacion provues, lidhur me sa më sipër kërkuar nga Komisioneri.

Kodi i Procedurës Administrative, në pikën 2, të nenit 85¹⁰, të tij ka parashikuar se: “Mungesa e përgjigjes ndaj njoftimit mund të merret parasysh për qëllimet e të provuarit, në përputhje me rrethanat e çështjes...”.

Në kontekst të sa më sipër, nga ana e Komisionerit është kërkuar informacioni dhe dokumentacioni i nevojshëm për vlerësimin e rrethanave e pretendimeve të palës ankuese, i cili disponohet nga pala kundër së cilës është paraqitur ankesa, Bashkia Korçë, por pavarësisht sa më sipër, është neglizhuar dërgimi i dokumentacionit të kërkuar për rastin e fëmijës S.J dhe nuk është vënë në dispozicion të tij për efekt të hetimit administrativ.

Për rrjedhojë, ndodhur në këto kushte, Komisioneri merr të mirëqenë deklarinimin e ankuesit lidhur me faktin se vajza e tij ka qenë përfituese e bursës për vitin shkollor 2022-2023, bazuar në kriterin ekonomik, dhe se për vitin shkollor 2023-2024, i është refuzuar ky përfitim.

Komisioneri, vëren se, për periudhën nga viti 2022 e deri në vitin 2024, kjo familje është trajtuar e vijon të trajtohet me ndihmë ekonomike nga ana e Bashkisë, në zbatim të drejtë të nenit 7/a, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas përcaktimeve të nenit 3, të tij, i cili zbatohet për familjet në nevojë, si një nga kategoritë përfituese të tij.

¹⁰ Mospraqitja e provave

Pra, kur Bashkia Korçë ka cilësuar familjen e ankuesit si familje përfituese të ndihmës ekonomike, automatikisht e ka konsideruar si familje në nevojë, që nuk ka të ardhura të mjaftueshme, kjo pasi prindërit e fëmijës, rezultojnë të jenë të regjistruar si punëkërkuar të papunë pranë ZV AKPA Korçë.

Për rrjedhojë, bazuar në sa më sipër, Komisioneri gjykon se Bashkia është kontradiktore dhe jo koherente në qëndrimin e saj, kur arsyeton se, nxënësja S.J nuk është përfituese e bursës për vitin shkollor 2023-2024, pasi:

- *Së pari*, Bashkia Korçë ka bërë vlerësime të kundërta të të njëjtave të dhëna e dokumentacion e dorëzuar nga ankuesi në vitin 2022 me atë të vitit 2023. Kështu, për vitin shkollor 2022-2023 e ka klasifikuar fëmijën e tij, si përfituese të bursës, bazuar në kriterin ekonomik të VKM-së përkatëse, ndërsa për vitin shkollor 2023-2024, nuk e ka klasifikuar si përfituese. Bashkia Korçë nuk ka dokumentuar apo argumentuar me fakte e prova se cilat kushte a rrethana të ankueses kishin ndryshuar në vitin 2023, që fëmija i tij nuk mund të klasifikohet si përfituese e bursës, në ndryshim nga viti paraardhës. Apo që të kishte ndryshuar VKM-ja përkatëse.
- *Së dyti*, Bashkia Korçë interpreton në mënyrë të gabuar pikën 2.1, shkronja c), të VKM-së respektive, kur citon se, sipas kësaj pike duhet të trajtohen me bursë nxënësit në pamundësi financiare, pa ndihmë ekonomike dhe me prindër të papunë, pasi, ajo përcakton shprehimisht se: “... përfitojnë bursë...c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë... në pamundësi financiare...”.
- Pra, kushti kumulativ dhe cilësimet: pa ndihmë ekonomike dhe me prindër të papunë, janë togfjalësha të shtuar nga ana e Bashkisë dhe që nuk citohen në pikën 2.1, shkronja c), të VKM-së përkatëse, dhe përfitues sipas kësaj pike të VKM-së, duhet të jenë nxënësit, “...fëmijë të familjeve në nevojë që janë regjistruar në arsimin bazë... në pamundësi financiare...”. Sikurse shihet, VKM-ja e lidh përfitimin e bursës me qenien e nxënësit, fëmijë i familjes në nevojë, në pamundësi financiare.
- *Së treti*, pamundësia financiare dhe qenia e familjes së ankuesit një familje në nevojë është fakt i njohur dhe pranuar nga Bashkia Korçë, pasi bazuar pikërisht mbi këto cilësi¹¹ ajo është trajtuar dhe vijon të trajtohet me ndihmë ekonomike, si familje në nevojë, që nuk ka të ardhura të mjaftueshme, për shkak se prindërit e fëmijës janë të papunë¹².
- *Së katërti*, VKM nr. 666, datë 10.10.2019, është një akt nënligjor i cili, ndër të tjera ka si bazë ligjore nenin 12 “Pagesa e ndihmës ekonomike”, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Pra, përfundimisht, Komisioneri vlerëson se, fëmija i ankuesit, bazuar në kriterin ekonomik të VKM-së përkatëse, duhet të ishte përfituese e bursës, njëlloj si në vitin shkollor paraardhës 2022-

¹¹Neni 7/a), i ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, citon se, përfituesit e ndihmës ekonomike janë: “.....a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme.”

¹² Regjistruar si punëkërkuar të papunë pranë zyrës rajonale përkatëse.

2023, si fëmijë i një familjeje në nevojë, njohur dhe dëshmuar me dokumentacion (vërtetim për trajtimin me ndihmë ekonomike) prej Bashkisë Korçë.

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se, deklaratimet e veprimet e Bashkisë Korçë, nuk qëndrojnë dhe bien në kundërshtim me faktet, provat e legjislacionin e analizuar më sipër.

Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se vajza e ankuesit, nxënësja S.J, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Korçë, lidhur me mospërfshirjen e saj në listën e përfituesve të bursës, sipas përcaktimeve të pikës 2.1/c), të VKM-së me nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të gjendjes ekonomike, të pretenduar nga pala ankuese si shkak diskriminimi, duke parashikuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, pretendohet se nxënësja S.J, e përfaqësuar përpara Komisionerit nga babai i saj, është diskriminuar për shkak të *gjendjes ekonomike*.

Në parim, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkakun i pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij.

Komisioneri vlerëson se “*gjendja ekonomike*” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD.

Gjendja ekonomike, si shkak i ndaluar diskriminimi, kryesisht lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërore, të cilët janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze dhe kjo pamundësi reflekton pastaj në braktisjen e shkollës ose në arritjet e nxënësve.

Komenti i Përgjithshëm nr. 20 “*Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*”, i Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i Kombeve të Bashkuara, parashikon: “*Situata sociale dhe ekonomike e një personi kur jeton në varfëri ose është i pastrehë mund të rezultojë në diskriminim të përhapur, stigmatizim dhe stereotipe negative që mund të çojnë në refuzimin ose aksesin e pabarabartë për të njëjtën cilësi të arsimit dhe kujdesit shëndetësor si të tjerët, si dhe mohim ose akses të pabarabartë në vendet publike*”.

Ligji nr. 57/2019 “*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar, përcakton se: “*Ndihma ekonomike, është mbështetja me para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, dhe se, përfituesit e ndihmës ekonomike janë: “.....a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme.*”

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, kategoria e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, dhe kanë fëmijë që ndjekin arsimin bazë, është kategori e familjeve në nevojë që e mbartin shkakun e mbrojtur.

Ankuesja ka depozituar dokumentacion me anën e të cilit provon shkakun e gjendjes ekonomike:

- Referuar “*Vërtetimit*” të Drejtorisë së Kujdesit Social/Bashkia Korçë, lëshuar në datën 23.12.2023, për familjen e F.J, vërtetohet fakti se është një familje e cila trajtohet me ndihmë ekonomike në shumën 6.300 lekë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminim duhet të shqyrtohet bazuar në shkakun e *gjendjes ekonomike*, pasi konsiderohet i provuar mbështetur në provat dhe faktet e administruara.

C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminim” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹³.

Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme¹⁴. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹⁵. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹⁶.

Në nenin 3, pika 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në

¹³ Shih: Molla kundër Greqisë, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; Fábíán kundër Hungarisë, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1985, prg.72.

¹⁴ Shih: Çështja Thlimmenos kundër Greqisë [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹⁵ Shih: Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹⁶ Shih: Çështjen Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen Thlimmenos, cituar më lart, prg. 44; Çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : *“7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit e bën edhe Kodi i Procedurave Administrative, duke parashikuar në nenin 82, pika 2, si vijon: *“2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Në këtë kuadër, në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga pala ankuese duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime *“...të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara¹⁷”.*

¹⁷ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Ruisisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni e ka zhvendosur barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se prima facie është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, fillimisht duhet të krijohet një prezumim i diskriminimit (diskriminimi prima facie), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁸

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është pikërisht bazuar në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në konkluzion të analizës sa më sipër, Komisioneri ka arritur në përfundimin se, nxënësja S.J, (fëmija i ankuesit), fëmijë i një familjeje që trajtohet me ndihmë ekonomike, i është nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm, nga ana e Bashkisë Korçë, lidhur me përjashtimin nga e drejta e përfitimit të bursës, bazuar në kriterin ekonomik, sipas pikës 2.1/c), të VKM-së me nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar. Në këto kushte, mbetet që të vlerësohet nëse për këtë diferencë në trajtim ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Komisioneri vlerëson se, qëllimi i Këshillit të Ministrave për trajtimin me bursë të nxënësve, familjet e të cilëve janë në pamundësi financiare, pasi janë familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, është i ligjshëm, pasi synon mbështetjen e tyre.

Identifikimi i shkakut të diskriminimit dhe analizimi i tij në një çështje diskriminimi është mjaft i rëndësishëm, jo thjesht për të konstatuar diskriminimin, por edhe për të dhënë një vendim sa më efektiv. Në çështjen në shqyrtim, Komisioneri ka identifikuar dhe vlerësuar se pala ankuese posedon një shkak të mbrojtur nga LMD, atë të “gjendjes ekonomike”.

E drejta për arsim, është një e drejtë themelore e njeriut, e sanksionuar në nenin 57¹⁹ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Shteti ka detyrimin që jo vetëm ta parashikojë, por

¹⁸ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

edhe ta përmbushë këtë të drejtë duke e garantuar atë. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të marrë masa pozitive për të siguruar dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, sidomos për grupet shoqërore më të pamundura, të cilat në të kundërt, nuk do të kenë mundësi të kenë qasje në regjistrimin apo ndjekjen e arsimit e për rrjedhojë do të jenë përherë në kushtet e braktisjes së shkollës.

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u arsimuar. Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës²⁰, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionon të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta dhe shtetet palë duhet të marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

Ligji 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar²¹, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënës duhet t'i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Këshilli i Ministrave për të garantuar të drejtën për arsim të të gjithë fëmijëve, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike si nga pushteti qendror dhe ai vendor, ka parashikuar trajtimin me bursë të të gjithë fëmijëve që i përkasin kësaj kategorie, që janë në kushte të vështira ekonomike.

Bashkia Korçë ka patur barrën e provës²² para Komisionerit për të provuar se pavarësisht faktit se familja e nxënëses S.J trajtohet me ndihmë ekonomike, ka një justifikim të arsyeshëm e objektiv për përjashtimin e fëmijës nga bursa.

Komisioneri gjen kontradiktor të pa arsyetuar qëndrimin e Bashkisë Korçë, lidhur me faktin se në të njëjtat kushte ekonomike të familjes së nxënëses S.J, për vitin shkollor 2022-2023 ajo i ka miratuar bursën e studimeve bazuar në pikën 2.1/c, të VKM-së objekt të kësaj ankese, ndërsa për vitin shkollor 2023-2024 nuk ja ka miratuar atë.

Po ashtu, trajtimi i familjes me ndihmë ekonomike nga ana e Bashkisë Korçë, automatikisht të çon në pasjen dijani prej saj, të gjendjes ekonomike dhe të ardhurave të pamjaftueshme të kësaj familjeje.

¹⁹ 1. Kushdo ka të drejtën për arsimim.5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.

²⁰ Neni 28 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës²⁰: 1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata: e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

²¹ Neni 5. E drejta për arsimim. 1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjisllacionin shqiptar.

²² Në referencë të neni 82, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe pika 7/1, e neni 33, të LMD-së.

Komisioneri vlerëson se, Bashkia Korçë interpreton në mënyrë të gabuar pikën 2.1, shkronja c), të VKM-së respektive, kur citon se, sipas kësaj pike duhet të trajtohen me bursë nxënësit në pamundësi financiare, pa ndihmë ekonomike dhe me prindër të papunë, pasi, ajo përcakton shprehimisht se: “:... përfitojnë bursë...c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë... në pamundësi financiare...”.

Pra, cilësimet: pa ndihmë ekonomike dhe me prindër të papunë, janë togfjalësha të shtuar nga ana e bashkisë dhe janë konsideruar prej saj si kushte kumulative, gjë që bie ndesh me pikën 2.1, shkronja c), të VKM-së përkatëse, pasi përfitues sipas kësaj pike të VKM-së, duhet të jenë nxënësit, “...fëmijë të familjeve në nevojë që janë regjistruar në arsimin bazë... në pamundësi financiare...”. Pra, VKM-ja e lidh përfitimin e bursës me qenien e nxënësit, fëmijë i familjes në nevojë, në pamundësi financiare.

Përfundimisht, Komisioneri vlerëson se, fëmija i ankuesit, bazuar në kriterin ekonomik të VKM-së përkatëse, duhet të ishte përfituese e bursës, njëlloj si në vitin shkollor paraardhës 2022-2023, si fëmijë i një familjeve në nevojë, njohur, pranuar dhe dëshmuar me dokumentacion (vërtetim për trajtimin me ndihmë ekonomike) prej Bashkisë Korçë.

Komisioneri vlerëson se nga informacionet e dërguara nga ana e Bashkisë Korçë, në asnjë rast nuk u arrit të provohej:

- Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga pala ankuese, që është gjendja ekonomike dhe trajtimin të pafavorshëm nga ana e bashkisë, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
- Që veprimet dhe mosveprimet e këtij subjekti kundrejt palës ankuese janë në përputhje me parashikimet ligjore, të drejta, objektive dhe të arsyeshme.

Për rrjedhojë, Komisioneri gjykon se, Bashkia Korçë ka keqinterpretuar klasifikimin që i bën nxënës S.J, vajza e ankuesit, si subjekt që nuk përfshihet tek kategoria përfituese, sipas pikës 2.1/c, të VKM-së respektive. Justifikimi i dhënë prej saj nuk është i arsyeshëm dhe objektiv. Ai është haptazi në kundërshtim me parashikimin ligjor të VKM-së së analizuar.

Bazuar në të dhënat e analizuara në vendim, Komisioneri vëren se, familja e fëmijës S.J plotëson kriterin e cilësuar në pikën 2.1/c, të VKM-së përkatëse, dhe ky fakt është i njohur dhe pranohet nga ana e bashkisë, pasi pikërisht për këtë arsye ajo është dhe përfituese e ndihmës ekonomike nga strukturat e saj.

Për sa më sipër, Komisioneri konstaton se fëmija e ankuesit, si anëtare e familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike, është vënë në pozita jo të favorshme, duke i mohuar mundësinë për të përfituar bursë, me qëllim sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës për të, si pjesë e kategorisë së nxënësve përfitues. Pra, fëmija e ankuesit është vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, nga ana e Bashkisë Korçë, për shkak të gjendjes ekonomike të familjes së saj.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030, ka si vizion²³ mbrojtjen sociale në një mjedis mundësues dhe fuqizues për çdo individ në nevojë, duke garantuar jetesë dinjitoze përgjatë ciklit të jetës. Një nga objektivat specifik/strategjik²⁴ të kësaj Strategjie është edhe “përmirësimi i shëndestrimit të fëmijëve, vajza dhe djem përmes skemave financiare të ndjeshme gjinore dhe një programi mbrojtje sociale me fokus fëmijët. Përmirësimi përfitimeve dhe bashkëpunimit ndër-sektorial me fokus fëmijët, vajzat dhe djemtë në skemën e ndihmës ekonomike me synim promovimin e mirëqënies së tyre.”

Ky dokument, ndër të tjera citon se: “Analiza të mëparshme kanë theksuar nevojën për të ofruar mbështetje të mëtejshme për familjet me fëmijë (të vegjël) në kushtet e pamjaftueshmërisë së skemave ekzistuese të mbështetjes në para dhe përfitimeve të tjera. Aktualisht ekzistojnë disa përfitime për përmirësimin e mirëqënies së fëmijëve në familjet në ndihmë ekonomike. Të tilla janë bonusi i bebes për çdo fëmijë të lindur, stimuli financiar për regjistrimin në shkollë dhe për vaksinimin, tekste shkollore falas, bursa mësimore, etj. Ekzistojnë dhe shërbime të tjera që merren nga një sërë institucionesh lokale dhe qendrore të cilat duhen identifikuar dhe analizuar. Evidentimi i të gjithë llojeve të përfitimeve dhe shërbimeve, analiza e kostove që lidhen me mirërritjen e fëmijëve do të mundësojnë ndërtimin e skenarëve të ndryshëm për të përmirësuar këto përfitime. Ekzistojnë modele dhe praktika ndërkombëtare mbështetjeje me përfitime për fëmijët në familjet në ndihmë ekonomike, të cilat do të njihen dhe do të përdoren për ndërtimin e skenarëve të mbështetjes për fëmijët në të ardhmen. Analiza të vijueshme për impaktin e këtyre skemave në mirëqënien e fëmijëve do të kryhen me qëllim realizimin e modifikimeve të nevojshme”.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030, lidhur me forcimin e bashkëpunimit ndërsektorial me fokus fëmijët në programin e NE-së, citon se: “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hedhur hapa të rëndësishëm dhe konkret drejt një modeli të shërbimeve të integruara shëndetësore dhe të mbrojtjes sociale për fëmijët përfitues të skemës së ndihmës ekonomike. Njëkohësisht lidhja me arsimimin është thelbësore për të garantuar të drejtën e fëmijëve në nevojë për siguruar qëndrimin në shkollë. Në veçanti, orientimi drejt një modeli të koordinuar mes shërbimeve sociale, arsimore dhe shëndetësore pritet të jetë një prej prioriteteve të strategjisë së re për garantimin e mbështetjes së fëmijëve dhe familjeve. Ky integrim i shërbimeve nis që në moshën 0-5 vjeç me paketën bazë të shëndetit të kujdesit parësor dhe programit të vizitave të integruara në familje si një mundësi për të adresuar në veçanti fëmijët vulnerabël, monitorimin e zhvillimit të hershëm dhe identifikimit të hershëm të aftësisë së kufizuar si dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërsektorial për të siguruar ndjekjen e treguesve të zhvillimit të fëmijës. Ky program aktualisht po zbatohet në qarqet Tiranë, Korçë, Elbasan, Vlorë, Lezhë, Kukës, Berat dhe synimi është të zgjerohet në të gjithë territorin.

Hartimi i protokolleve të përbashkëta, organizimi i tryezave të përbashkëta në nivel rajonal mes shërbimeve sociale dhe atyre shëndetësore si dhe ngritja e kapaciteteve të personelit socio-

3.1. ²³ Vizioni

²⁴ Objektivi specifik/strategjik A3.

shëndetësor do të jenë në fokus në strategjinë e re. Njëkohësisht, pjesë e kësaj mase prioritare do të jetë vlerësimi i fizibilitetit, kapaciteteve institucionale dhe personelit për të hartuar një Plan Veprimi për Garancinë e Fëmijëve sipas modelit dhe udhëzimeve të Bashkimit Evropian. Hartimi i një Plani Veprimi për Garancinë e Fëmijëve është një prej rekomandimeve të Bashkimit Evropian si pjesë e kapitullit 19 për hapjen e negociatave si dhe në përputhje me kapitullin 23 për të drejtat e njeriut. Plani i Veprimit për Garancinë e Fëmijëve, aktualisht po zbatohet në një sërë vendesh të Bashkimit Evropian, dhe ashtu sikurse Plani i Garancisë Rinore do të synojë të ndërtojë modele, mjete dhe financim për adresimin e fëmijëve vulnerabël, të garantojë një plan për reduktimin e varfërisë së fëmijëve dhe nxitur mirëqenien e tyre.”

Dokumenti i Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026²⁵, në vizionin e tij ka: *“Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimit gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian”.*

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, ndër objektivat e saj specifik ka parashikuar dhe objektivin specifik A.2, ku citohet: *“Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve për të ulur braktisjen dhe për t’u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë;...”.*

Gjithashtu, Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, ndër të tjera synon të sigurojë një kujdes të veçantë vajzave dhe djemve në rrezik braktisje, si dhe atyre nga grupet vulnerabël: fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe, në përgjithësi, nga grupet shoqërore të marginalizuara, vajzave dhe djemve që rikthehen nga emigracioni, fëmijët viklima dhe viklima të mundshme të trafikimit, fëmijëve në konflikt me ligjin, si dhe pjesëtarëve të pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane²⁶.

Në analizë për sa më sipër, me miratimin e këtij dokumenti strategjik, Qeveria shqiptare merr përsipër obligimin të sigurojë përfshirjen sociale, ekonomike dhe kulturore, ndër të tjera edhe paketa mbështetëse për arsimimin e fëmijëve që vijnë nga familje në nevojë duke i garantuar atyre një jetesë sa më dinjitoze.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”*, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të Ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet: *“Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.*

Ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e

²⁵ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 22.10.2021.

²⁶ Paragrafi i fundit i faqes 61, të Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026.

Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson si masë të duhur për rregullimin e situatës, marrjen e masave të menjëhershme nga Bashkia Korçë, si institucioni përgjegjës, për trajtimin me bursë për vitin shkollor 2023-2024, të nxënës S.J, si fëmijë që vjen nga një familje që trajtohet me ndihmë ekonomike dhe që ndjek arsimin parauniversitar me kohë të plotë në institucionet arsimore publike.

Po ashtu, Komisioneri sjell në vëmendje të Bashkisë Korçë, që të marrë masa konkrete dhe efektive për përfshirjen e të gjithë nxënësve që ndjekin arsimin bazë dhe që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, në kategorinë e nxënësve që duhet të përfitojnë bursë, gjatë periudhës së ndjekjes së shkollës.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 7/1, nenin 11, nenin 18/1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të nxënës S.J²⁷, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Korçë, si fëmijë i një familjeje që trajtohet me ndihmë ekonomike.
2. Bashkia Korçë të marrë masa efektive, për trajtimin me bursë, për vitin shkollor 2023-2024, të nxënës S.J, bazuar në kriterin ekonomik, sipas pikës 2.1/c, të VKM nr. nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.
3. Me qëllim për të shmangur situata të tjera të ngjashme, si në rastin konkret, rekomandohet Bashkia Korçë, të marrë masa paraprake efektive, për rregullimin e situatave të tilla.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

²⁷ Përfaqësuar nga babai, z. F.J.

5. Në referim të nenit 33, pika 13, të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA